



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 252/ Prot

Shkodër, më 15. 08. 2018

V E N D I M

Nr. 306, datë 15. 08. 2018

"PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PROJEKT BUXHETIT 2019-2021"

Në mbështetje të Ligjit nr.80, dt.22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit nr. 109/2017 "Për buxhetin e vitit 2018", ligjit nr.10296, dt.08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të Udhëzimit nr. 7, datë 28.2.2018 Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm; Udhëzimi nr. 7/1, datë 28.02.2018 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2019-2021", vendimin e Senatit Akademik nr 298 datë 13.08.2018

VENDOSI :

1. Të miratojë kuotat e programit buxhetor afatmesëm për periudhën 2019-2021 të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", sipas pasqyrave tip të planifikimit buxhetor bashkangjitur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Administratori për zbatimin e këtij vendimi
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT TE ADMINISTRIMIT

Eduard Ndreca



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

MIRATOHET

KRYETARI

Edi Ndreca



"KUOTAT E PROJEKT BUXHETIT 2019-2021"

Në mbështetje të ligjit nr.9936, dt.26.06.2008 „Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë“, të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.109/2017 dt,30.11.2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, udhëzimit të Ministrit të Financave nr.2, dt. 06.02.2012”Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit“, VKM nr.75 dt. 12.2.2018 “Për miratimin e modelit te financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë”, udhëzimit nr.9 datë 20.03.2018 ”Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit“, Udhëzimi nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, Udhëzimi nr. 7/1, datë 28.02.2018 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2019-2021”, Vendimit te Senatit akademik nr.81, dt. 26.02.2018 “Per miratimin e planit te veprimeve”, grupi i punës i ngritur nga administratori i institucionit me Urdhërin e Brendshëm nr.283 datë 18.07.2018, në respektim të kuadrit ligjor të sipërcituar ka përgatitur materialin bashkëngjitur.

Objektivat kryesore në hartimin e këtij projekt-buxheti janë:

- ✓ Plotesimi i nevojave te paraqitura nga fakultetet
- ✓ Krijimi i kushteve bashkëkohore për mësimdhënie
- ✓ Përdorimi me efikasitet të fondeve buxhetore
- ✓ Përmirësimi i cilësisë së mjediseve mësimore duke krijuar kushte sa më bashkëkohore për të ofruar një shërbim sa më cilësor.
- ✓ Përmirësimi i cilësisë së lehtësirave dhe akomodimit të studentëve.
- ✓ Menaxhimi i burimeve njerëzore në mënyrë që të kemi qasje me kriteret për akreditimin institucional sipas vendimit të Bordit të Akreditimit nr.70, dt.21.09.2017 dhe Vendimit te Senatit akademik nr.81, dt. 26.02.2018 “Per miratimin e planit te veprimeve” .

- ✓ Plotësimi i strukturës organizative në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe me synimin për të zvogëluar numrin e punonjësve me kohë të pjesshme, me kriteret e akreditimit institucional.
- ✓ Mbështetje maksimale ndaj kualifikimit shkencor si dhe kërkuesve të rinj në mënyrë që të rritet pjesëmarrja në konferenca si dhe nxitja e mëtejshme drejt kërkimit shkencor.
- ✓ Dixhitalizimi i veprimtarisë mësimore-kërkimore si dhe asaj administrativo-financiare, data base për regjistrat themeltar.
- ✓ Mbajtja e një stabiliteti financiar ndonëse numri i studentëve që kanë aplikuar për të përfituar për t'u përjashtuar nga tarifat e shkollimit në mbështetje të VKM-së nr.269, datë 29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit" ka trend rrites nga viti në vit
- ✓ Rritja e performancës së institucionit në mirë-menaxhimin e aseteve financiare në dispozicion.
- ✓ Përmirësimi i kushteve të punës së personelit

Në zbatim të ligjit nr. Ligjit nr.80, dt.22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, neni 109:

1. Institucionet publike të arsimit të lartë financohen nga:

- a) buxheti i Shtetit;*
- b) pagesat e studentëve për arsimim;*
- c) të ardhurat për shërbimet e kryera;*
- ç) të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta;*
- d) donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi;*
- dh) veprimtari kërkimore-shkencore;*

Kemi planifikuar të hyra vetëm nga financimet prej: buxhetit të shtetit, pagesat e studentëve për arsimim, të ardhurat e krijuara nga shërbimet e kryera si vërtetime, diploma, programe, analiza dhe nga të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta si qeratë.




1. Fondet nga Buxheti i Shtetit të cilat shpërndahen në formë granti, sipas kategorive të mëposhtme:

- a) granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë;
- b) granti i mësimdhënies;
- c) granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese.

Sqarojme se planifikimi është bërë mbi një strukturë të plotë sa i takon stafit të brendshëm me kohë të plotë, pra për një total prej 344 punonjësish.

Njesia	Nr.stafi i brendshëm	Ped.te jashtëm nr.stafi
FGJH	32	36
FSHSH	55	17
FSHN	68	129
FSHE	54	49
F.EK	43	47
FD	26	11
rektorati	53	
BIBLIOTEKA	13	
Totali	344	289



Nga buxheti i shtetit kemi planifikuar një grant total prej 598.057.000 leke për të mbuluar shpenzimet korente (paga, kontribute, shpenzime operative, kompensime dhe transferta me jashtë-kuota anetarësimi, kerkim shkencor dhe investime).



Planifikimi I shpenzimeve nga granti per vitin 2019

ne mije lek

Njesia	Nr.punonjes te brendshem	Paga Bruto	Sig.shoqerore	Shp.operative	kerklm shkencor	totali nga granti
Rektorati	53	57808.98	8497.2558	5234.875		71541.11047
FSHN	68	74170.012	10902.14	6733.925	1000	92806.07616
FSHSH	55	59990.451	8817.907	6359.075	1000	76167.43256
FSHE	54	58899.715	8657.5814	6359.075	1000	74916.37151
FGJH	32	34903.535	5130.4186	5234.875	1000	46268.82849
F.EKONOMIK	43	46901.625	6894	5984.225	1000	60779.85
Drejtësia	26	28359.122	4168.4651	4485.175	1000	38012.76221
Biblioteka	13	14179.561	2084.2326	2986.125		19249.9186
Totall	344	375213	55152	43377.35	6000	425742.35
Bursa						38594
Kuote anetaresimi						150
investime						73571
Subtotal		375213	55152	43377.35	6000	592057.35

Jane planifikuar te shpenzohen 593.057.000 leke granti per te mbuluar shpenzimet per:

Paga dhe shp.te tjera personeli staf me kohe te plote 375.213.000 lek

Kontribute shoqerore dhe shendetsore 55.152.000 leke

Shp.operative 43.377.350 leke

Bursa 38.594.000 leke

Kuote anetaresimi 150.000 lek


Kerkim shkencor 6.000.000 leke

Investime 73.571.000 leke

Kosto lokale tvsh 1.000.000 leke

Totali i shpenzimeve nga te granti 593.057.350 leke

Fondi I planifikuar per shpenzime operative per vitin financiar 2019 eshte ne masen 43.377.000 lek, (nga granti) afro 40.5% e totalit te shpenzimeve operative te planifikuara.




Nga buxheti i shtetit kemi planifikuar një grant prej 6.000.000 lekë për të mbuluar shpenzimet për studime: kërkim-shkencor. Ky fond është vendosur duke pasur parasysh kërkesat e fakulteteve.

Është planifikuar të aplikohet tek Fondi i zhvillimit të rajoneve me projektin: Rikonstruksion Godina e Rektoratit me vlerë totale 298.611.000 lek. Sipas rregullave të FZHR, nga kjo vlerë 70% është planifikuar për t'u financuar nga FZHR dhe 30 % nga të ardhurat tona. Zbatimi i këtij projekti shtrihet në një plan financimi për 3 vite (2019-2021)

a. Për hartimin e projekt buxhetit në artikullin 600 "Pagat e punonjësve" + 601 "Kontribute për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore"

Baza Ligjore


- ✓ Kodi i punës i R.SH
- ✓ Ligji nr.80, dt.22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",
- ✓ Udhëzimit nr. 20, dt.09.05.2008 "Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë", i ndryshuar me udhëzimin nr. 40, dt. 08.12.2009 "Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë" i ndryshuar
- ✓ Udhëzimi nr.26, datë 16.04.2009 i Ministrit të Financave "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore", i ndryshuar
- ✓ Ligji nr.7703, date 11.05.1193 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar
- ✓ Ligji nr.10383, datë 24.02.2011 "Për sigurimin e detyrueshem të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar
- ✓ Ligji nr.184/2013 datë 28.12.2013 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10383, datë 24.02.2011 "Për sigurimin e detyrueshem të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë"
- ✓ Ligji nr.9136, date 11.09.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar
- ✓ Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në R.SH", të ndryshuar.
- ✓ Ligji nr.7870 dt.13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në R.SH", të ndryshuar.
- ✓ VKM nr.1114 dt.30.07.2008 "Për disa çështje në zbatim të ligjeve të sigurimeve" të ndryshuar me VKM nr.581 dt.17.07.2013
- ✓ VKM nr.748, dt. 11.06.2009 "Për trajtimin me page dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë" të ndryshuar me VKM nr.589 datë 17.07.2013, VKM nr.268, dt.29.03.2017
- ✓ VKM nr.717 dt.23.06.2009 "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore" të ndryshuar me VKM nr. 610 date 24.07.2013




- ✓ Ligji nr.104/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në R.SH", të ndryshuar.
- ✓ VKM nr. 399 dt.03.05.2017 "Per pagën minimale"
- ✓ udhëzimit nr.23, datë 09.12.2014 i MF „Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore“
- ✓ Udhëzimit nr.31, datë 29.12.2014 i MF „Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.5 datë 30.01.2006 „Për tatimin mbi të ardhurat“, të ndryshuar
- ✓ Vkm nr. 77, datë 28.01.2015 „ Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor“
- ✓ Në zbatim të Vendimit nr. 187, datë 8.3.2017 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësimit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrave të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit",
- ✓ Në zbatim të Vendimit nr. 175, datë 8.3.2017 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar" i ndryshuar.
- ✓ Në zbatim të Vendimit nr. 268, datë 29.3.2017 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të këshillit të ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë", i ndryshuar.
- ✓ Në zbatim të Vendimit nr. 202, datë 15.03.2017 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në Vendim nr.717, datë 23.6.2009 "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", i ndryshuar.
- ✓ Në zbatim të Vendimit nr. 399, datë 3.5.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", duke pasur parasysh pagën bazë minimale mujore për punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person juridik a fizik, vendas ose i huaj të jetë 24 000 (njëzet e dy mijë) lekë. Paga bazë minimale mujore jepet për 174 (njëqind e shtatëdhjetë e katër) orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës. Paga bazë minimale orare të jetë 127 (njëqind e njëzet e shtatë) lekë/ ditë si dhe shtesat me karakter të përhershëm jepen mbi pagën bazë konform ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Për Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë".

Hartimi i projekt-buxhetit në zërin "Pagat e Punonjësve" për periudhën 2019-2021, është realizuar sipas metodës së përcaktuar në Manualin për Klasifikimin Buxhetor Ekonomik miratuar nga Ministria e financave. Në këto tabela pasqyrohet planifikimi i fondit të pagave për vitin 2019. Planifikimi i fondit të pagave është bazuar në strukturën analitike të personelit të miratuar për vitin 2018, (sipas vendimit të BA nr.144, dt.13.04.2018 "Për miratimin e strukturese përgjithshme e kategorizimin e pagave për vitin 2018") si dhe janë marrë në konsideratë ndryshimet e mundshme në grada e tituj të stafit akademik.

Hartimi i buxhetit në zërin "pagat e punonjësve" në sistemin e arsimit mbështetet në nivelin aktual të pagave duke përfshirë të gjithë elementët e pagës dhe shtesat mbi pagën e



punonjësve të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Parashikimi për vitin 2019 është bërë duke marrë në konsideratë tavanin 105.850 lekë në lidhje me pagën maksimale dhe 24.000 leke lidhur me pagën minimale.




b. Për hartimin e projekt buxhetit në artikullin 602 “Mallra dhe shërbime të tjera”

Projekt- buxheti në këtë artikull përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e mallrave dhe shërbimeve, të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së përditshme të institucionit. Këtu nuk përfshihen shpenzimet për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara. Hartimi i projekt- buxhetit për vitin 2019, bazohet në tregues analitikë të shpenzimeve, shpenzimet e pritshme dhe objektivat që synohen të arrihen sipas nevojave të paraqitura.

Hartimi i buxhetit për mallra dhe shërbime realizohet duke u mbështur në “Manualin për Klasifikimin Ekonomik”. Në planifikimin e këtij artikulli janë patur parasysh normativat e harxhimit të materialeve si dhe shërbimet e tjera të domosdoshme që përfitojnë institucionet nga të tretët në shërbim të studenteve dhe stafit mesimdhënes, ndihmës e mbështetës, për të arritur në standarde real dhe tregues të matshëm .

Në hartimin e projekt- buxhetit është patur parasysh dhe mirëmbajtja e ambienteve mësimore dhe zhvillimi i praktikave profesionale në bazat e tyre didaktike, si dhe ekspeditat me



karakter mësimor praktik. Konstatohet se programet e praktikave mësimore jashtë rrethit, vazhdojnë të përbëjnë një kosto të lartë për IAL-në.

Referimi për mallrat dhe shërbimet është bërë duke u bazuar tek nevoja e fakulteteve, e shprehur në kërkesat e tyre zyrtare po ashtu edhe në kërkesat e vitit që shkoi të përfshira në buxhetin e vitit 2018 për pamundësi financimi.


Tarifat e akreditimit janë një tjetër ze i planifikuar në këtë projekt-buxhet mqs procesi i akreditimit të programeve të studimit planifikohet të vijojë në vitet pas-ardhëse. Shifra është vendosur në masën 4.000.000 leke, pavarësisht se jo nga të gjitha fakultetet kemi pasur kërkesa specifike.

Planifikimi i shpenzimeve operative

Për vitin 2019 është planifikuar që shpenzimet operative të jenë në masën 107.080.000 leke, nga të cilat afro 40.5% janë planifikuar të mbulohen nga buxheti i shtetit dhe 55.5% nga të ardhurat tona.


Njesia	Fondi total per shpenzime operative ne 000/leke	Ne %
Fshn	17,133	16.00%
Fshsh	16,062	15.00%
Fshe	16,062	15.00%
F. Ekon	14,991	14.00%
Fgj.h	12,850	12.00%
F.Drejt	10,708	10.00%
Bibliot	6,425	6.00%
Rektorati	12,850	12.00%
Totali	107,080	100.00%

VO: Materiali i detajuar bashkëngjitur sipas fakulteteve



Shpenzime operative 2019 ne rang universiteti

Artikulli	Shpenzime operative 2019	Kerkesa
602.0	Materiale zyre dhe te pergjithshme	6,860,000
60201.0	kancelari	3,000,000
602.02	Materiale per pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndricim solucione pastrime, fshesa pastrimi, shtupa pastrimi, kova shtupe, bishta fshese, solucine per duar	2,000,000
602.03	Materiale per funksionimin e pajisjeve te zyles materiale qe dalin gjate punes per te ble per mirembajtjen e paisjeve te zyreve si per bateri, pjese ele	300,000
	krtonike per kompjutera etj	
602.04	Materiale e vegla e mjete pune per punoniesit e mirembajtjes	200,000
	vegla pune per punetoret e mirembajtjes	
602.05	Blerje dokumentacioni sherbime printimi dhe publikime, flesa	960,000
602.09	Furnizime dhe materiale te tjera zyre dhe te pergjishme materiale elektrike, hidraulike, uniforme per punonjesit, bojra muri dhe materiale te tjera te nevojshme qe nevojiten si per hotelet dhe per te tjera materiale te pa perfshira ne zerat e tjere	400,000
602.1	Materiale dhe sherbime speciale	6,099,000
602.1	Uniforma dhe veshje te tjera speciale (bluzat e punes per sanitaret, bibliotekaret, laborantet, çizme	100,000
602.101	Materiale dhe pajisje laboratorike te sherbimit publik materiale per laboratoret e sherbimit publik, te lab te kimise, biologjise, zoologjise, infermierise	3940000
602.1010	Shpenzime per prodhim dokumentacioni specifik (diploma)	960,000
602.11	Te tjera materiale dhe sherbime speciale materiale dhe sherbime speciale per blerje gjate vitit te pa parashikuara qe mund te dalin si per	1,099,000
	shtypshkronjen etj	
602.2	Sherbime nga te trete	53,100,000
602.2	Elektricitet	8,000,000
602.2	Uje	3,000,000
602.2	Sherbime telefonike	
	Telefoni fikse	400,000
	Telefoni Celulare	400,000
	Sherbim interneti	400,000
602.2	Posta dhe sherbimi korrier per dergimet me poste nga universiteti tarifat e pagesave	200,000
6022005	Blerje gazoil per ngrohje per kaldajat dhe per automjetin	6,500,000
6022008	Sherbimi I ruajtjes dhe sigurise fizike	34,000,000
602.21	Sherbime te tjera, sherbime te tjera te pa parachikuara qe mund te dalin gjate vitit	200,000
602.3	Shpenzime transporti	1,300,000
602.31	Vajra dhe lubrifikante per automjetin e USH	600,000



602.32	Pjese kembimi, goma dhe bateri	200,000
602.33	Shpenzimet per koalidimin e mjeteve te transportit	400,000
602.39	Shpenzime te tjera transporti per bajtjen dhe transportimin e materialeve	100,000
602.4	Shpenzime udhetimi	7,800,000
602.40	Udhetim i brendshem	7,000,000
	Nga ky per ekspeditat me studentet	6,200,000
	per stafet	800,000
602.41	Udhetim jashte shtetit+ ceepus	800,000
602.5	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	17,261,000
602.51	Shpenzime per mirembajtjen e objekteve specifike per shembull te shtypshkronjes, paisjeve eletriike elektronike	200,000
602.52	Shpenzime per mirembajtjen e objekteve ndertimore	15,761,000
602.53	Shpenzime per kontrollin vjetore te fikseve te zjarrit per kontrollin dhe rimbushjen me solucion te fikseve te zjarrit	300,000
602.54	Shpenzime per mirembajtjen e aparateve, paisjeve teknike dhe veglave te punes	800,000
602.55	Shpenzime per mirembajtjen e mjeteve te transportit	200,000
602.9	Shpenzime te tjera operative	14,660,000
602.9	Shpenzime per pritje e percjellje	400,000
602.9	Shpenzime per aktivite sociale, per personelin	960,000
602.9	Shpenzime gjyqesore	100,000
602.9	Shpenzime per sigurimin e ndertesave dhe te tjera kosto sigurimi te ngjashme	500,000
6029	Tarifa akreditimi	4,000,000
602.901	Shpenzime per honorare	8,000,000
602.901	Shpenzime per tatime & taksa te paguara nga institucioni	600,000
602.901	shpenzime per pjesemarrje ne konferenca	333333
602.91	Shpenzime per te tjera materiale dhe sherbime operative	100,000
	Totali	107,080,000

Art. 606 "Transferime korrente të brendshme, bursat e studentëve".

Ky artikull përfshin të gjitha ato shpenzime për të cilat institucioni nuk përfiton mallra ose shërbime. Hartimi i buxhetit në këtë artikull pasqyron kërkesat e universitetit për bursat e studenteve të cilat planifikohen sipas kuotës të miratuar për bursat, numrit të bursave të ndërmjetëme dhe studenteve të shkëlqyer që paguhen në Universitete, bazuar ne në VKM "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, bursat e shtetit dhe pagesat e nxënësve dhe të studentëve në institucionet arsimore publike", po ashtu edhe fondi per kompensim energjie elektrike ne masen 6.000 lek.




Eshte planifikuar shuma prej 38.594.000 leke qe mbulohet nga granti i pakushtezuar (buxheti i shtetit).

2. Fondet nga:


- a) pagesat e studentëve për arsimim;
- b) të ardhurat për shërbimet e kryera;
- c) të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta;

Arketimet jane planifikuar te realizohen mbeshtetur ne:

Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 112, ligjin nr.10296 dt.08.07.2010" Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", udhëzimin të MF nr.30, dt.27.12.2011" Për menaxhimin e caktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", Ligjin nr.9936 date 26.6.2008" Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne republiken e Shqiperise" si dhe ne VKM date 29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit". Sa i takon tarifave te shkollimit per vitin akademik 2018-2019, planifikimi eshte bere nisur vendimi nr.20, dt.15.01.2018 I senatit akademik "Per miratimin e kuotave te ciklit te pare, te dyte dhe te trete te studimeve viti akademik 2018-2019", vendimit te BA nr. 212, dt.07.06.2018 "Per miratimin e tarifave vjetore te shkollimit per ciklin e pare te studimeve per vitin akademik 2018-2019", vendimit te senatit akademik nr.285, dt.19.07.2018 "Per miratimin e tarifave per ciklin e dyte te programeve te studimeve master professional dhe master shkencor per vitin akademik 2018-2019".



Permbledhese e te ardhurave sipas fakulteteve



Planifikimi per vitin 2019

ne mije lek

Njesia	Tarife shkollimi bachelor	Tarife shkollimi MP	Tarife shkollimi MSH	Dr	Tarife regjist+aplikimi	Konkurse	Sherblime laboratorike	Totali
FSHE	15990	11025	7211		1449.8	790		36466
FSHSH	11550	7731	-875	1245	1195			20846
FGJH	9660	11040			798			21498
F.Drejtësi	15197		11873		1070.6			28140
F.Ekonomik	15910	16620	9396		1563			43489
FSHN	28501	13413	3694		1765.3		2500	49873
REKTORATI sherbime+qera			0					4500
Totali	96808	59829	31298	1245	7841.7	790	2500	204812

Eshtë planifikuar një realizim të ardhurash per vitin financiar 2019 në masën 204.812.000 lekë duke marrë parasysh kuotat e miratuara për vitin akedemik 2018-2019 dhe studentët që vijnë studimet.


Nuk kemi marrë parasysh studentet stazhier dhe as studentet potencial për t'u perjashtuar/reduktuar nga tarifa e shkollimit.(efekti+/-). Mos parashikimi ne vlere I

studenteve perserites /piket kredite per lendet perseritese lidhet me faktin rritjes se nivelit te perjashtimeve/reduktimeve nga tarifa e shkollimit,(trend ne rritje 3 vitet e fundit).

Vo: Eshte marre ne konsiderate nje mos realizim kuotash ne masen 15% per ciklin e pare e te dyte te studimeve.

Jane planifikuar te shpenzohen 204.812.000 leke nga te ardhurat per te mbuluar shpenzimet per:

Ore suplementare	22.100.000 lek
Ore ped.me kohe te pjeshsme	27.100.000 leke
Kontribute shoqerore dhe shendetsore	6.500.000 leke
Shp.operative	63.703.000 leke
Investime dhe kerkim shkencor	85.509.000 leke
Totali i shpenzimeve nga te ardhurat	204.812.000 leke



Buxheti i Investimeve

Planifikimi i investimeve është bërë në mënyrë të hollësishme për të gjitha shpënzimet kapitale që universiteti mbulon. Investimet janë të prezantuara sipas formularit tip. Çdo ide e paraqitur është e shoqëruar me koston e përafërt. Referimi për investimet është bërë duke u bazuar tek nevoja e fakulteteve e shprehur në kërkesat zyrtare të tyre. Njekohësisht janë marre për baze nevojat që njesite kanë paraqitur edhe në PBA-ne 2018-2020 por që nuk janë zbatuar gjatë vitit 2018.


NDËRTIMET/Paisjet e ndryshme

Prioritetet kanë qenë:

- Objektet në vazhdim
- Objektet në kushte jo të favorshme për mësimdhënie dhe që mund të rehabilitohen
- Pajisje kompjuterike
- Inventar ekonomik
- Pajisje sipas nevojave të fakulteteve të ndryshme

Investimet e planifikuara për vitin 2019

Emertimi i projektit të investimit	kerkesa buxhetore për periudhën 2019-2021	Parashikimi për vitin 2019		
		shuma totale 2019	Burimi grant	Burimi të ardhura
Projekte të reja dhe në vazhdim	Në mijë lek			
Rikonstruksion salla e konf. FGJH	10863	10863	10863	
Sistemi i mbrojtjes nga zjarrit	40418	20209		20209
Rrufeprites, tokezim dhe stabilizim tensioni e rryme në godinat e Universitetit të Shkodrës.	6692	6692		6692
Rikonstruksion godina e rektoratit	298611	89583	62708	26875
Pajisje kompjuterike	13057	13057		13057
Pajisje për inventar ekonomik	1370	1370		1370
Bleje pajisje mobilieri projekti Helix	630	630		630
Kerkim Shkencore	6000	6000	6000	



Laboratori i fizioterapise	2840	2840		2840
Laboratori i informatikes	2572	2572		2572
lab.kimise organike kerkim shkencor	2646	2646		2646
Laboratori i informatikes per mesimdhenie	10908	3636		3636
Kondicioner per Dep	2600	2600		2600
Pajsje sportive per dep e e eduk fizi e sp	400	400		400
Vegla Muzikore	710	710		710
Libra per Artet+sportet+biblioteken	1272	1272		1272
TOTALI	407589	171080	85572	85509

Planifikimi I shpenzimeve nga te dy burimet e financimit per vitin 2019

Zeri	Financimi nga granti	Financimi nga te ardhurat	Totali I financimit nga te dy burimet
Shp.paga staf I brendshem	375213		375213
Shp.paga staf I brendshem ore suplementare		22000	22000
Shp.paga staf akademik I jashtem		27100	27100
Shp.kontribute staf I brendshem	55152		55152
Shp.kontribute staf I jashtem+kontrate		6500	6500
Shp.operative	43377	63703	107080
SHp.transferta me jashte	150		150
SHp.bursa + kompensime	38594		38594
Shp.investime	73572	85,509	159081
Kerkim shkencor nga granti	6000		6000
Kosto lokale tvsh projekti	1000		1000
Totali I shpenzimeve	593058	204812	797870

Totali i shpenzimeve nga te granti

593.057.350 leke

Totali i shpenzimeve nga te ardhurat

204.812.000 leke

Plan financimi total

797.869.000 leke



Shpresojme qe ky projekt-buxhet t'i sherbeje mbarevajtjes se Institucionit tone si nga pikepamja edukative e mesimdhenies dhe e kerkimit shkencor ashtu edhe nga ajo administrative.

Bashkëngjitur këtij material janë formularët përkatës (formulet Tip) për parashikimin e fondit të pagave e sigurimeve shoqërore e shëndetsore, të shpenzimeve operative dhe të investimeve që parashikohen të realizohen nga institucioni ynë vitin që vjen.

MIRATOI

KRYETARI

Eduard Ndreca

